



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 10.12.2019

**RAPORT
PËR
PROJEKTLIGJIN “PËR SHKËMBIMIN AUTOMATIK TË INFORMACIONIT TË
LLOGARIVE FINANCIARE”**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 10.12.2019, mori në shqyrtim projektligjin “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare”.

Relatore për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua deputetja znj. Elena Xhina.

Në mbledhjen e komisionit, për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të komisionit, ishte i pranishëm z. Elton Haxhi, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë.

I. BAZA KUSHTETUESE

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA

Nënshkrimi i Marrëveshjes Model Shumëpalëshe të Autoriteteve Kompetente, në zbatim të nenit 6 “Shkëmbimi Automatik i Informacionit” të Konventës për Ndihmën Administrative të Ndërsjelltë në Çështjet Tatimore, të cilën Shqipëria e ka miratuar me ligjin nr. 146/2013, datë 6.05.2013, sjell angazhimin e vendit tonë për zbatimin e shkëmbimit automatik të informacionit midis vendeve pjesëmarrëse në këtë marrëveshje.

Aktualisht në vendin tonë mungon një kuadër rregullator në fushën e shkëmbimit automatik të informacionit. Krijimi i një kuadri të ri ligjor do të ndihmojë në çrrënjosjen e krimit të evazionit fiskal dhe trajtimin e mashtrimit fiskal. Nëpërmjet shkëmbimit automatik të informacionit, në rastet e konstatimit të evazionit fiskal, merren masat për parandalimin dhe shmangien e tij.

Projektligji ka për qëllim të realizojë shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare me vendet pjesëmarrëse në marrëveshje, duke synuar rritjen e të ardhurave, shmangien e evazionit fiskal, kontrollin më të mirë të zbatimit të marrëveshjeve të taksimit të dyfishtë, verifikimin e të ardhurave të tatimpaguesve etj.

Objektivat që synohen të arrihen janë:

- a) të krijohet një mjet efikas për realizimin e shkëmbimit automatik të informacionit, në zbatim të Standardit të Përbashkët të Raportimit dhe Marrëveshjes Shumëpalëshe të Autoritetit Kompetent për Shkëmbimin Automatik të Informacionit të Llogarive Financiare të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 178, datë 09.03.2016;
- b) të garantohet mbledhja e inforaportimit të Institucioneve Financiare Raportuese për mbledhjen dhe raportimin e informacioneve të caktuara financiare pranë Autoritetit Kompetent, në përputhje me Standardin e Përbashkët të Raportimit;
- c) të përcaktohen termat dhe kushtet e përgjithshme që lidhen me grumbullimin, përpunimin, përditësimin, bashkëveprimin, përjasjen, ruajtjen, përdorimin dhe arkivimin e informacionit në lidhje me Shkëmbimin Automatik të Informacionit të Llogarive Financiare në çështjet tatimore;
- d) të përcaktohen detyrat dhe kompetencat e autoritetit kompetent për të siguruar zbatimin efektiv dhe përputhshmërinë me Standardin e Përbashkët të Raportimit, duke përfshirë marrjen dhe përdorimin e informacionit.

Në përmbajtjen e projektligjit parashikohen procedurat e raportimit e të verifikimit të duhur që qëndrojnë në themel të shkëmbimit automatik të informacionit të llogarisë financiare, rregullat që u kërkojnë institucioneve financiare për të raportuar informacionin në pajtim me qëllimin e raportimit dhe për të ndjekur procedurat e verifikimit të duhur në zbatim të Standartit të Përbashkët të Raportimit. Gjithashtu, përcaktohen shkeljet e kryera që konsiderohen kundërvajtje administrative, sanksionet/penalitetet që vendosen dhe procedura e apelit lidhur me moszbatimin në përputhje me rregullat dhe procedurat e vendosura në këtë projektligj. Parashikohen rregullat për konfidencialitetin dhe sigurimin e të dhënave. Ruajtja e konfidencialitetit të informacionit të tatimpaguesit ka qenë gjithmonë thelbësore në sistemin tatimor. Si tatimpaguesit dhe administratat tatimore kanë të drejtën ligjore të presin që informacioni i shkëmbyer të mbetet konfidencial. Me qëllim që të kenë besim në sistemet e tyre tatimore dhe të përmbushin detyrimet e tyre sipas ligjit, tatimpaguesit duhet të dinë se informacioni financiar, shpesh sensitiv, nuk i jepet palëve të tjera në mënyrë të papërshtatshme, as me qëllim dhe as aksidentalisht.

III.KONSULTIMI I PROJEKTLIGJIT

Në datën 13.11.2019 Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut i është drejtuar Komisionierit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me një kërkesë për mendim lidhur me përputhshmërinë e parashikimeve të këtij projektligji për procesin e përpunimit dhe shkëmbimit të të dhënave personale të karakterit financiar dhe parashikimeve të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.

Në përgjigje të kërkesës, Komisioneri informoi Komisionin më datë 18.11.2019 se projektligji i është dërguar paraprakisht për mendim nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Zyra e Komisionerit ka dhënë sugjerimet mbi këtë projektligj dhe konstaton se në tërësi janë reflektuar sugjerimet e dhëna, duke i mbetur qëndrimit për reflektimin e një prej parimeve të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në këtë kuadër, Komisioneri vlerëson se projektligji i depozituar në Kuvendin e Shqipërisë është hartuar konform ligjit nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

IV. DISKUTIME NË KOMISION

Gjatë prezantimit të projektligjit, z. Elton Haxhi, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë shpjegoi për anëtarët e Komisionit se me vendimin nr.178, datë 9.3.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e marrëveshjes shumëpalëshe, të autoritetit kompetent, për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarisë financiare” parashikohej që shkëmbimi automatik i informacionit të realizohej brenda vitit 2018, por për shkaqe objektive është kërkuar shtyrje deri në vitin 2020, me qëllim për të përgatitur infrastrukturën e nevojshme për shkëmbimin e këtij informacioni. Ai parashtroi nevojën e miratimit të projektligjit me qëllim që shkëmbimi i informacionit të llogarive financiare të fillojë brenda vitit 2020.

Diskutime pati në komision lidhur me nenin 18 të projektligjit i cili i referohet dispozitave kalimtare. Nga relatorja e projektligjit znj. Elena Xhina dhe anëtarët e tjerë të komisionit u diskutua nëse duhet të përcaktohet në dispozitë afati kohor i aplikimit të ligjit dhe konkretisht data 1.1.2019, apo ky rregullim të bëhet në aktet nënligjore në zbatim të tij. Në përfundim të diskutimeve, duke u dakortësuar dhe me përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Komisioni e çmoi si të rëndësishme që t’ia përcjellë komisionit përgjegjës në vlerësimin e tij.

Komisioni, gjatë shqyrtimit nen për nen të projektligjit, miratoi disa ndryshime në tekstin e projektligjit, kryesisht riformulime të teknikës së hartimit të projektligjit, të cilat ia propozon komisionit përgjegjës.

V. PROPOZIME PËR NDRYSHIME NEN PËR NEN

1. Në nenin 1 të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- Pjesa hyrëse e nenit 1 të riformulohet “ *Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave dhe procedurave në lidhje me:*”.
- Në shkronjën “a” të përcaktohet lloji i informacionit si dhe të hiqet referenca në VKM, pasi ajo përcaktohet tek neni i përkufizimeve (*neni 4, shkronja “dh”*). Propozohet të bëhet riformulimi si më poshtë:

- “a) shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare, në zbatim të standardit të përbashkët të raportimit dhe marrëveshjes shumëpalëshe të autoritetit kompetent për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare;”*
- Në shkronjën “ç” *“detyrat dhe kompetencat”* të zëvendësohen me *“të drejtat dhe detyrimet”*.
- 2. Në nenin 2** referenca në Konventë, të zëvendësohet me “standartet ndërkombëtare” Propozohet që parimet e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale të jenë një nen më vete pas këtij neni dhe neni 2 të riformulohet si më poshtë:
- “Neni 2
Qëllimi*
- Ky ligj synon zbatimin e standardeve ndërkombëtare për shmangien e mashtrimit tatimor dhe të evazionit fiskal si dhe përmirësimin e pajtueshmërisë tatimore kombëtare e ndërkombëtare.”*
- 3. Pas nenit 2,** të shtohet **neni 2/1** me këtë përmbajtje:
- “Neni 2/1
Parim i përgjithshëm*
- Shkëmbimi automatik i informacionit të llogarive financiare bëhet duke zbatuar dispozitat e konfidencialitetit dhe të mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi.”*
- 4. Në nenin 3,** të hiqet *“dhe në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave, referuar pikës 4, të nenit 5, të këtij ligji.”*
- 5. Në nenin 4** të bëhen ndryshimet e mëposhtme:
- Në shkronjën “a” të saktësohet marrëveshja *“marrëveshjen shumëpalëshe në këtë fushë”*.
 - Në shkronjën “b” të hiqet lidhëza *”por”*.
 - Në shkronjën “ç” të hiqet referenca në VKM dhe të bëhet riformulimi si më poshtë:
“ ç) Juridiksion i raportueshëm”, një juridiksion i identifikuar në listën e publikuar, sipas përcaktimeve në aktet nënligjore të nxjerra për zbatimin e këtij ligji.”
 - Pas shkronjës “g” të shtohet shkronja *“gj”* ku të përkufizohet se çfarë është komentari.
- 6. Në nenin 5** të bëhen ndryshimet e mëposhtme:
- Në pikën 1, *“referuar pikës 4 të këtij neni”* të zëvendësohet me *“të specifikuara në aktet nënligjore në zbatim të ligjit”*.
 - Pika 3 të riformulohet si më poshtë:
“3. Informacioni duhet të dërgohet elektronikisht, sipas një formati të standardizuar, duke përdorur teknologjinë e përshtatshme, në përputhje me aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.”
 - Pika 4 të hiqet dhe të lidhet me nenin 17 *“Aktet nënligjore”*.
- 7. Në nenin 6** referencat në VKM të zëvendësohen me *“aktet nënligjore për zbatimin e ligjit”*.

8. Në nenin 7, në pikën 3 “mbetet” të zëvendësohet me “është”. Të hiqet “detyrimin” dhe të zëvendësohet referenca në VKM me “aktet nënligjore në zbatim të tij”.

9. Në nenin 8, të bëhen riformulimet e mëposhtme:

- Pika 1 riformulohet si më poshtë:

“1. Autoriteti kompetent, nëpërmjet strukturave të tij të varësisë, mund të kërkojë informacion, nga çdo institucion financiar raportues në Republikën e Shqipërisë. Me lajmërim paraprak, ai mund të hyjë në ambientet ku ushtrohet veprimtaria ekonomike e tij, me qëllim verifikimin e përmbushjes së detyrimit të përcaktuar me këtë ligj.”

- Pika 2 riformulohet si më poshtë:

“2. Brenda 7 ditëve pune nga paraqitja e kërkesës me shkrim të autoritetit kompetent, institucioni financiar raportues i vë në dispozicion regjistrimet apo të dhënat e mbajtura sipas nenit 9 të këtij ligji, si dhe çdo dokument tjetër që kërkohet për të kryer verifikimin e përmbushjes së detyrimit të përcaktuar me këtë ligj.”

- **Të hiqet pika 3.**

- **Në pikën 4** fjalia “Ky detyrim përfshin, por nuk kufizohet vetëm në:” të zëvendësohet me “Informacioni shtesë vec detyrimeve të tjera përmban:”.

10. Në nenin 9, tek shkronja “a” të plotësohet forma e mbajtjes së të dhënave nga “letër” në “dokument letër”.

11. Neni 10 të riformulohet si më poshtë:

“Neni 10

Shkëmbimi i informacionit mbi llogaritë e raportueshme

Autoriteti kompetent, në përputhje me standardet ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë, shkëmben me autoritete të tjera kompetente çdo vit, brenda nëntëmuorit të parë dhe në mënyrë automatike, informacionet e marra në bazë të procedurave dhe rregullave të specifikuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij.”

12. Në nenin 11 të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- Në pikën 1 togfjalëshi “shkeljet e kryera” të zëvendësohet me “veprimet ose mosveprimet e kryera”.

- Në shkronjën “b”, “c” referenca në VKM të zëvendësohet me “aktet nënligjore në zbatim të ligjit”.

- Shkronja “c” të riformulohet si më poshtë:

“c. Mosdhënia e informacionit të kërkuar nga çdo mbajtës i llogarive të raportueshme ose person tjetër përgjegjës, në kundërshtim me kërkesat e këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, përveç nëse ky informacion ka të bëjë me një person të tretë dhe provohet se mosveprimi nuk ishte i qëllimshëm, dënohet me 1,000,000 (një milion) lekë gjobë;”

- Pas shkronjës “c” të shtohet shkronja “c/1” me këtë përmbajtje:

“c/1. Kryerja e deklarimit të rremë nga cdo mbajtës i llogarive të raportueshme ose person tjetër përgjegjës, në kundërshtim me kërkesat e këtij ligji dhe akteve

nënligjore në zbatim të tij, dënohet me 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë gjobë;”.

- Shkronja “ç” të riformulohet si më poshtë:
“ç) Pengimi nga personat përgjegjës, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, me qëllim mosushtrimin e të drejtave dhe detyrave të Autoritetit Kompetent të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij, dënohet me 1 000 000 (një milion) lekë gjobë;”
- Shkronja “d” të riformulohet si më poshtë:
“d. Zbatimi në mënyrë të gabuar i rregullave të vendosura mbi vigjilencën e duhur, si pasojë e neglizhencës nga personi që ka për detyrë t’i zbatojë ato dënohet me 100,00 (njëqind mijë) lekë gjobë.
- Pas shkronjës “d” të shtohet shkronja “d/1” me këtë përmbajtje:
“d/1 Kryerja me dashje e veprimeve në kundërshtim me rregullat e vendosura mbi vigjilencën e duhur, nga subjektet përgjegjëse, dënohet me 250,000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë gjobë.”

13. Në nenin 12 referenca “sipas parashikimeve të nenit 106, të ligjit 9920, datë 19.5.2008.....” të zëvendësohet me “sipas legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

14. Në nenin 13 referenca në VKM të zëvendësohet me “aktet nënligjore në zbatim të tij”.

15. Në nenin 14 të bëhen riformulimet e mëposhte:

- Pika 1 riformulohet si më poshtë:
“1. Informacioni i siguruar nga institucionet financiare raportuese në Republikën e Shqipërisë është konfidencial.”
- Pika 4 riformulohet si më poshtë:
“4. Informacioni i marrë nga autoritetet kompetente të huaja duhet të mbahet konfidencial, në përputhje me standardet ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë dhe legjislacioni vendas.”

16. Në nenin 16 referenca në VKM të zëvendësohet me “aktet nënligjore në zbatim të tij”.

17. Neni 17 të riformulohet duke përcaktuar dispozitat e ligjit në zbatim të të cilave do të nxirren aktet nënligjore.

18. Propozimet e mësipërme për ndryshime duhet të reflektohen dhe në numërtimin përfundimtar të neneve të projektligjit si dhe në referencat përkatëse.

VI. PËRFUNDIME

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

a) *Në aspektin ligjor*, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

b) *Në aspektin procedural*, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e shumicës së anëtarëve të komisionit e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

RELATORE

ELENA XHINA

KRYETARI

ULSI MANJA